

Si të përdoret

JU LUTEM, LEXOJINI ME KUJDES
UDHËZIMET PËRPARA PËRDORIMIT!


Testi i shtatzënisë Surecheck mund të përdoret që nga DITA E PARË e vonesës e menstruacioneve si edhe në çdo MOMENT gjatë 24 orëve.

Përpara se të filloni:


1. Lexojeni me kujdes udhëzimet.
2. Sigurojeni një orë dore ose muri ose diçka tjetër që të matni kohën.
3. Verifikoni datën e skadencës të kutisë. Mos përdorni testin, n.q.s. ka skaduar.

Mënyra e përdorimit:

1. Nixirreni testin nga kutia në momentin e përdorimit.
2. Pikoni 3-4 pika urinë në dritaren e vogël me ndihmën e pikatores.



3. Shikoni rezultatin në minutën e 5-të dhe jo më vonë se në minutën e 10-të.



Rezultatet:



NUK JENI SHTATZËNË:

Tregohet vetëm një vijë e ngjyrosur në zonën e kontrollit (C).



JENI SHTATZËNË:

Tregohen vija të ngjyrosura në zonën e kontrollit (C) dhe në zonën e testimit (T).

Rezultati i pavlefshëm: N.q.s. nuk tregohet ndonjë vijë deri në minutën e 5-të në zonën e kontrollit (C), atëherë rezultati është i pavlefshëm. Përsëriteni testin me test të ri Surecheck. Testi s'është i rregullt/i vlefshëm, n.q.s. nxirret nga paketimi më herët se 15-të minuta përpara përdorimit. **Mbasi keni parë rezultatin mos bëni asgjë pa u konsultuar me mjekun tuaj!**

Pyetjet që bëhen më shpesh:

1. Si funksionon testi Surecheck?

Testi për shtatzëni Surecheck tregon prezencën e hormonit hCG (human Chorionic Gonadotropin), i cili fillon të shfaqet ngapak para fekundimit. Kur pikat e urinës, të cilat përmbajnë hCG hormonin fillojnë të bashkëveprojnë me testin e shtatzëni isë, atëherë në dritaren e vogël të rezultatit tregohen dy vija.

2. Kur mund ta përdor testin?

Testi për shtatzëni Surecheck mund të përdoret që nga dita e parë e vonesës të menstruacioneve/ciklit mujor në çdo moment të ditës. Urina e parë e mëngjesit zakonisht përmban përqëndrim më të lartë të hormonit hCG.

3. Kam menstruacionet jo të rregullta. Si mund ta kuptoj kur të përdor testin?

Kur keni menstruacionet jo të rregulla mund të përdorni testin Surecheck 19 (nëntëmbëdhjetë) ditë mbas ditës që mendoni se keni ngjatur shtatzëni. N.q.s.

rezultati është negativ mund ta përsërisni testin edhe një herë mbas 48-të orëve.

4. Çfarë të bëj, n.q.s. vija e testit (T) është pak e ngjyrosur ose e zbehtë?

Bëni test të ri mbas 48 orëve. Ngjyra e shiritit të testit mund të ndryshojë, sepse etapet e ndryshme të shtatzënisë kanë përqëndrime të ndryshme hormonesh hCG.

5. A ka faktorë që mund të ndikojnë tek rezultati?

- Disa barna si Humegon, Pregnil, Profasi, Pergonal, A.P.L. mund të përmbajnë hormonin hCG. Përdorimi i tyre mund të ndikojë në saktësinë e rezultatiit.
 - N.q.s. përdorni testin Surecheck në kohën deri 8 javë mbas lindjes ose abortit, mund të tregojë rezultat pozitiv prej hormonit hCG të përqëndruar që ka në organizmin e gruas. N.s.q. jeni e shqetësuar kontaktoni me mjekun tuaj, që të tregoni ose konsultoheni për rezultatin.
 - Lëngjet e tepërta që konsumohen mund të ulin përqëndrimin e hormonit hCG në urinë dhe mund të ndryshojë rezultatin.
- Përdorimi i barnave kontraceptive, i antibiotikëve, analgjekëve (kundër dhimbjeve) dhe alkooli nuk ndikon tek rezultati.

Çdo kuti e testit Surecheck përmban: Paketim mbrojtës që përmban: Test për shtatzëni Surecheck me pikatore; qese e vogël tharëse që thith lagështirat, të mos hahet; Udhëzimet e përdorimit; Kalendar. **Blu Cross Bio-Medical Co. LTD, Zona industriale Beiqijia, RPK 102209, IECREP Shanghai International Holding Corp. GmbH (Europe) Hamburg, Germany.** **Δ** Të ruhet nga fëmijët. Nuk është për përdorim të brendshëm. Testi është vetëm për përdorim personal. Testi përdoret edhe për diagnostikim in vitro. Të ruhet nga drita, temperatura dhe lagështira. Ndjeshmëria e testit: 25 mIU/ml. **Të ruhet në temperature midis 4° - 30°C.**



Rishikim i Fundit: 12.07.2017

Surecheck.

By UniComs Switzerland GmbH.